



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 93, Datë 04.07.2017

PËR

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “PPC ALBANIA” SH.A., NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Bordi i ERE me Vendimin nr. 72, datë 11.05.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjise elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë Shoqërinë “PPC ALBANIA” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI